



Informacione për vaksinimin “Covid-19” në vjeshtë 2022 për persona të rrezikuar në mënyrë të veçantë

Më të rëndësishmet shkurtimisht

- Personat që janë veçanërisht të rrezikuar për ecuri të rënda të “Covid-19” mund të përmirësojnë, të paktën përkohësisht, mbrojtjen e tyre kundër ecurisë së rëndë të sëmundjeve me vaksinimin përtëritës në vjeshtë të vitit 2022.
- Vaksinimi përtëritës në vjeshtë të vitit 2022 iu këshillohet fort të gjithë personave të rrezikuar në mënyrë të veçantë:
 - Personave nga mosha 65 vjeç
 - Personave nga mosha 16 vjeç me sëmundje të caktuara kronike
 - Personave nga mosha 16 vjeç me trisomi 21
 - Shtatzëna
- Vaksinimi kundër “Covid-19” është i sigurt – edhe për persona në moshë të lartë dhe me sëmundje të caktuara kronike¹ si dhe për gratë shtatzëna.
- Për informacione plotësuese → [Fletëshpjegim «Informacione për vaksinimin “Covid-19”»](#)

Cilët persona vlejné si të rrezikuar në mënyrë të veçantë?

- a) Personat nga mosha 65 vjeç
- b) Personat nga mosha 16 vjeç me forma të caktuar të sëmundjeve kronike të mëposhtme¹:
 - Hipertension/presion i lartë i gjakut
 - Sëmundje të sistemit kardiovaskular
 - Diabet
 - Sëmundje të mushkërisë dhe të rrugëve të frymëmarrjes
 - Kancer
 - Sëmundje dhe terapi, të cilat dobësojnë sistemin e imunitetit
 - Obeziteti (IMT ≥ 35 kg/m²)
 - Insuficienca e veshkave
 - Cirroza e mëlçisë
- c) Persona nga mosha 16 vjeç me trisomi 21
- d) Gratë shtatzëna

Çfarë do të thotë “i rrezikuar në mënyrë të veçantë”?

Pasi një infektimi me virusin korona, ju keni një rrezik të lartë për një ecuri të rëndë të sëmundjes nga “Covid-19”. Mbrojtja nga vaksinimi e vaksinimeve të deritanishme mund të dobësohet. “Covid-19” mund të ketë për ju pasoja të rënda madje shumë të rënda. Për shembull vështirësi të mëdha në frymëmarrje në rast të një infeksioni të mushkërive. Atëherë ju keni nevojë për oksigjen dhe duhet të çoheni në spital. Mund të zgjatë shumë derisa ju të jeni përsëri i shëndetshëm. Nëse ecuria e sëmundjes përkeqësohet, ju duhet të trajtoheni në stacionin e kujdesit intensiv. Ndoshta ju keni nevojë për frymëmarrje artificiale. “Covid-19” mund të dëmtojë përveç kësaj organet dhe në rastin më të keq ju mund të vdisni prej tij.

Pas një infektimi me ecuri të rëndë mund të shfaqen probleme shëndetësore që vazhdojnë për një kohë të gjatë (sëmundje pas- “Covid-19”) – si për shembull vështirësi në frymëmarrje gjatë punëve të mundimshme, lodhje ose probleme përqendrimi.

Përse këshillohet vaksinimi përtëritës në vjeshtë të vitit 2022?

Nëpërmjet rritjes së kontakteve në hapësirat e brendshme ka të ngjarë që nga vjeshta e vitit 2022 virusi korona do të transmetohet përsëri më shumë ndërmjet njerëzve. Rreziku i infektimit respektivisht i sëmundjes nga “Covid-19” do të jetë kështu përsëri më i lartë në sezonin e dimrit.

Ju keni një rrezik të lartë për një ecuri të rëndë të sëmundjes dhe tek ju ulet më së pari mbrojtja nga vaksinimet e mëparshme. Vaksinimi ju ofron të paktën një mbrojtje të përkohshme të përmirësuar individuale ndaj sëmundjes së rëndë dhe komplikimeve të saj. Nëse vaksinoheni, ju ulni përveç kësaj rrezikun e pasojave të mundshme afatgjata (sëmundje pas- “Covid-19”).

Kur duhet bërë vaksinimi përtëritës?

Vaksinimi përtëritës në vjeshtë të vitit 2022 mund të bëhet nga 4 muaj pas vaksinimit të fundit kundër “Covid-19” respektivisht nga 4 muaj pas një infeksioni të njohur me virusin korona. Kjo vlen edhe për personat e rrezikuar në mënyrë të veçantë të cilët kanë marrë tanimë një vaksinim të dytë përtëritës. Ju mund të rrisni përsëri në këtë mënyrë mbrojtjen tuaj personale ndaj një ecurie të rëndë të sëmundjes.

¹ Listën e hollësishme të sëmundjeve e gjeni nën:
Kategoritë e personave të rrezikuar në mënyrë të veçantë

Vaksinime të tjera me lëndë të tjera të çaktivizuara të vaksinimit (si p.sh. vaksina kundër gripit) mund të bëhen para, në të njëjtën kohë me një vaksinimi "Covid-19" ose pas kësaj.

Ju lutemi, vini re: A keni temperaturë të lartë? A jeni i sëmurë dhe nuk ndiheni mirë? Atëherë shtyjeni terminin për vaksinim.

Cila lëndë vaksinimi këshillohet?

Për vaksinimin në vjeshtë ne këshillojmë me përparësi vaksinimin me një lëndë mRNA vaksinimi (bivalente) të përshtatur me variantin ose me vaksinën e proteinës "Novavax" kur këto janë të disponueshme. Gjatë kësaj nuk ka rëndësi se me cilën lëndë vaksinimi u bënë vaksinat e deritanishme.

Në rastin e lëndëve mRNA për vaksinim (Pfizer/BioNTech ose Moderna) janë të përshtatshme për vaksinimin përtëritës në vjeshtë e vitit 2022 si lëndët e deritanishme (monovalente) të vaksinimit, ashtu edhe një lëndë e vaksinimit (bivalente) e përshtatur me variantin. Të dhënat aktuale tregojnë se lëndët monovalente mRNA të vaksinimit vazhdojnë të ofrojnë edhe më tej mbrojtje të mirë kundër ecurive të rënda me shtrime në spital edhe me variantet e reja të Omikron.

E rëndësishme: Shtatzëna dhe persona që ushqejnë me gji do të duhej të linin të vaksinoheshin me një lëndë mRNA vaksinimi (jo me lëndën proteinë të vaksinimit nga Novavax).

Çfarë vlen, nëse unë deri tani nuk jam vaksinuar ende kundër "Covid-19"?

Të gjithë personat që janë të rrezikuar në mënyrë të veçantë dhe të cilët në vjeshtë e vitit 2022 janë ende të pa vaksinuar këshillohet të vaksinohen me dy doza të "Covid-19" në një distancë prej 4 javësh.²

Si mund të mbrohem unë si shtesë?

Nëse ju bëni pjesë në personat e rrezikuar në mënyrë të veçantë, ju mund të mbroheni me masa plotësuese nga një infektim me virusin korona (p.sh. mbani një maskë në ambientet e brendshme). Orientohuni për këtë në parimet tona bazë → [Faqja e internetit «Kështu mbrohem ne»](#).

Çfarë vlen për personat e përkujdesjes të personave të rrezikuar në mënyrë të veçantë?

Vaksinimi përtëritës iu këshillohet të gjithë personave të përkujdesjes dhe personave të kualifikuar shëndetësorë, të cilët duan të zvogëlojnë disi rrezikun e tyre të infektimit, me qëllim që të ruajnë kujdesin e personave të rrezikuar në mënyrë të veçantë dhe për të siguruar kujdesin shëndetësor.

Vaksinimi i mëtejshëm përtëritës i ofron këtij grupi një mbrojtje të ulët dhe afatshkurtër kundër infeksioneve me sëmundje të lehtë: Bartja e virusit mbi persona të tjerë pothuajse nuk mund të pengohet.

Informacione të mëtejshme

Kostot: Një vaksinim i këshilluar kundër "Covid-19" është pa pagesë për ju.

Mundësi të vaksinimit: Informohuni në faqen e uebit ose në linjën e informimit të kantonit tuaj (www.foph-coronavirus.ch/cantons), se ku mund të lini ju të vaksinoheni.

Informacione të mëtejshme mbi vaksinimin kundër "COVID-19" ju mund të gjeni në faqen e internetit të FOPH: www.foph-coronavirus.ch/vaccination ose pyesni mjeken ose mjekun tuaj. Ose në farmacinë tuaj.

Linke:

→ [How does the COVID-19 vaccination work? | FOPH \(foph-coronavirus.ch\)](#)

→ [Frequently Asked Questions \(FAQs\) \(admin.ch\)](#)



² Për persona nën moshën 30 vjeç kryesisht me lëndën e vaksinimit Pfizer/BioNTech.